



Informacione për prindërit për mësimin në gjuhën dhe në kulturën amtare

Volksschulamt
Besondere Förderung, Interkulturelle Pädagogik
ikp@vsa.zh.ch

korrik 2020
1/3

Albanisch
hartuar në tetor 2013, aktualizuar në qershor 2020

Çka është mësimi në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK)?

Mësimi në gjuhën dhe në kulturën amtare është mësim plotësues gjuhësor për fëmijët që nuk e kanë gjermanishten gjuhë të parë ose të dytë. Fëmijët në moshë të obligimit shkollor që nga kopshti i fëmijëve e deri në përfundim të shkollimit fillor mund ta ndjekin mësimin në gjuhën dhe kulturën amtare (shkurtesa gjermanisht: HSK).

Mësimi në gjuhën dhe kulturën amtare ka për qëllim që të nxisë mësimin e gjuhës së parë dhe ofron njohuri themelore mbi regjionin gjuhësor. Mësimi në gjuhën dhe kulturën amtare është neutral në aspektin politik dhe religjioz. Në të trajtohen mënyrat e shkuarjes me forma të ndryshme të jetesës dhe me përkatësi të ndryshme. Ai përforcon kompetencën gjuhësore dhe i ndihmon ata në krijimin e identitetit të tyre dhe në integrim. Drejtoria e Arsimit preferon ndjekjen e mësimin të tillë.

Si është i organizuar mësimi në gjuhën dhe në kulturën amtare?

Mësimi në gjuhën dhe në kulturën amtare është i rregulluar me ligj sipas Ligjit mbi shkollimin fillor të Cyrihut. Kompetent për lejimin dhe koordinimin e kurseve në gjuhën dhe në kulturën amtare është Enti i Shkollimit Fillor. Ofertuese të kurseve janë ambasadat, konsullatat dhe shoqatat. Ato organizojnë kurset në gjuhën dhe kulturën amtare dhe bëjnë punësimin e mësimdhënësve. Për këtë arsye mësimi plotësues zhvillohet vetëm në ato gjuhë për të cilat ekzistojnë edhe bartës të këtij mësimi. Varësisht nga ofertat e ndonjërës prej gjuhëve, me mësim mbulohen të gjitha nivelet apo vetëm nivele të caktuara. Vetë Enti i Shkollimit Fillor nuk ofron mësim në gjuhën dhe kulturën amtare.

Kurset e gjuhës dhe kulturës amtare, që i plotësojnë normat kantonale, bëjnë pjesë në mesin e kurseve të pranuar të gjuhës dhe të kulturës amtare. Ato plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Mësimi është neutral në aspektin politik dhe religjioz si dhe i hapur për të gjithë fëmijët e grupit gjuhësor.
- Mësimi nuk ka orientim përfitues. Pagesa vendoset me qëllim të sigurimit të funksionimit të mësimin.
- Mësimdhënësit janë të kualifikuar në aspektin pedagogjik, kanë njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes dhe kanë ndjekur kursin obligues të arsimimit të mëtejme të Entit të Shkollimit Fillor.

Njohja e kursit lejon shfrytëzimin pa pagesë të lokaleve shkollore dhe mundëson bartjen e notave të kursit të gjuhës dhe të kulturës amtare në dëftesën zyrtare të Shkollës Fillore të Cyrihut.

Orari i mësimin dhe dispenzimi

Numri i leksioneve javore është rregulluar me ligj. Në ciklin e kopshtit dhe në klasën e parë janë të lejuara deri në 2 leksione në javë; nga klasa e dytë deri në katër leksione në javë.

Mësimi në gjuhën dhe në kulturën e atdheut mbahet kryesisht jashtë orarit të rregullt mësimor. Nëse mësimi mbahet brenda orarit të rregullt, fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të dispensohen (lirohen) nga mësimi i rregullt për më së shumti dy leksione. Për këtë prindërit duhet t'i parashtrojnë kërkesë drejtorisë shkollore. Me këtë rast duhet vlerësuar se cili prej mësimëve shkon më shumë në të mirë të fëmijës. Enti i Shkollimit Fillor preferon që çështja të bisedohet me kujdestarin e klasës.

Vendi i mbajtjes së mësimit dhe orari i mësimit online

Mësimi në gjuhën dhe në kulturën amtare mbahet zakonisht në hapësirat e shkollës publike, sipas mundësive në afërsi të vendbanimit të fëmijëve. Disa ofertues të mësimit në gjuhën dhe në kulturën amtare posedojnë edhe hapësirat e tyre të mësimdhënies.

Një pasqyrë të të gjitha gjuhëve, vendeve dhe të kohës së mbajtjes së mësimit i gjeni në orarin mësimor kantonal online (<https://www.hsk-kantonzuerich.ch/>). Këtu mund të kërkonit sipas gjuhës, nivelit dhe vendit kursin adekuat në gjuhën dhe kulturës amtare për fëmijën Tuaj.

Nota e kursit në gjuhën dhe kulturën amtare në dëftesën e shkollës fillore

Mësimdhënësi i gjuhës dhe kulturës i vlerëson rezultatet dhe të arriturat mësimore të fëmijëve me notë nga 1 deri në 6 duke i vendosur në vlerësim-formularin e Entit të Shkollimit Fillor të Cyrihut. Kujdestari i klasës i bart notat në dëftesë. Shumica e vendeve të prejardhjes njohin zyrtarisht ndjekjen e kurseve të gjuhës dhe të kulturës amtare.

Si ta lajmëroj fëmijën tim?

Pranimi bëhet zakonisht në fillim të vitit të ri shkollor.

Të gjitha shkollat në Kantonin e Cyrihut marrin në janar një prospekt me kurset e pranuar nga Enti i Shkollimit Fillor. Ky prospekt ju shpërndahet fëmijëve. Lajmërimi bëhet nga prindërit deri në fund të marsit, do me thënë rreth katër muaj para fillimit të vitit shkollor. Ju mund t'i lajmëroni fëmijët drejtpërdrejt te bartësit e kurseve që gjenden në prospekt ose online përmes linkut të dhënë në prospekt. Në rast se ekziston varësia nga ndihmat sociale, shumë prej komunave i marrin përsipër shpenzimet.

Cilat janë dobitë e mësimit në gjuhën dhe në kulturën amtare?

Një mësim i mirë në gjuhën dhe kulturën amtare ka këto përparësi:

- ✓ Fëmijët dhe të rinjtë i thelojnë njohuritë e tyre në gjuhën e tyre të parë – në të kuptuar dhe në të folur, në të lexuar dhe në të shkruar. Kjo është një vlerë në vete.
- ✓ Kush e zotëron mirë gjuhën e parë, zakonisht mëson më lehtë gjuhën e dytë, gjermanishten, dhe gjuhët e huaja.

- ✓ Mësimi i gjuhës dhe i kulturës amtare mund të ndikojë përgjithësisht pozitivisht në suksesin në mësim në shkollën publike, sepse e shton vetëbesimin dhe i zgjeron njohuritë e përgjithshme.
- ✓ Shumë-gjuhësia është një resurs i vlefshëm për një zhvillim të suksesshëm profesional në botën e globalizuar.
- ✓ Njohuritë e mira të gjuhës së parë i ndihmojnë fëmijës për mbajtjen e kontakteve me familjen dhe me të afërmit dhe i ndihmojnë atij në një kthim të mundshëm më të lehtë në vendin e prejardhjes respektivisht në regjionin gjuhësor.

Si mund ta ndihmoni ju si prind zhvillimin gjuhësor të fëmijës Tuaj shumë-gjuhësor?

Flisni me fëmijën Tuaj në gjuhën që e flisni krejt spontanisht dhe natyrshëm dhe të cilën e zotëroni më së miri. Supozimi se një fëmijë e ka më lehtë në shkollë, nëse prindërit e tij me gjuhë të huaj amtare flasin gjermanisht, është krejt i gabueshëm.

Shmangeni në bisedë me fëmijët Tuaj përzjerjen e gjuhës Tuaj amtare dhe të gjuhës gjermane. Qëndroni pranë gjuhës Tuaj edhe atëherë kur fëmija Juaj përgjigjet gjermanisht. Por, lejoni fëmijës Tuaj të përgjigjet në gjuhën që ai do.

Nëse nëna dhe babai flasin gjuhë të ndryshme amtare, këtë mund ta bëni edhe me fëmijën Tuaj. Edhe këtu janë të rëndësishme rregullat e qarta: “Nëna flet këtë gjuhë, babai këtë, kurse gjatë të ngrënit ne flasim këtë gjuhë”.

Mos lejoni t’ju hutojnë krizat: ndoshta fëmija Juaj në një fazë të caktuar flet vetëm gjermanisht, edhe pse e kupton gjuhën Tuaj. Nëse Ju qëndroni konsekuent në gjuhën Tuaj, fëmija, nga të dëgjuarit edhe më tej të saj, me siguri se do ta flasë këtë gjuhë në një fazë të mëvonshme.

Përkrahni ndjenjën e gëzimit të fëmijës në gjuhën Tuaj duke lexuar së bashku libra të ilustruar, duke thënë rima, duke kënduar, duke dëgjuar muzikë, duke treguar dhe lexuar tregime.

Kujdesuni për atë që fëmija Juaj që nga vegjëlja të ketë kontakte të shumta me gjuhën gjermane. Jini vetë i hapur për gjuhën gjermane dhe mësojeni atë. Ju jeni një shembull për fëmijën Tuaj.

Dërgojeni fëmijën Tuaj (mundësisht që nga kopshti) në mësimin e gjuhës dhe të kulturës amtare dhe lejoni t’ju tregojë rregullisht se çka ka mësuar atje.

Mbani kontakte të rregullta me mësuesit e klasës së rregullt dhe me atë të kurseve të gjuhës dhe të kulturës amtare.